- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operatori Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Njoftimin e Kontratës, Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoritetikontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve sipas zërave të preventivit

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Grafiku i realizimit të punimeve

Shtojca 7: Formularët e Përshtatshmërisë dhe Kualifikimit të Ofertuesve

Shtojca 8: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9: Formulari i Vlerësimit

Shtojca 10: Preventivat e Punimeve

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.

Shtojca 12 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Shtojca 13 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për AutoritetitKontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontrates;
 3. Kriteret e Vlerësimit;
 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 6. Preventivin e çmimeve
 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Shtojca2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventividhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa çmim do të konsiderohen si zëratë paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomikee detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimii Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]
 [*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrimi shkurtëri i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] kalendarin e depozitës pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedhadhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] sikusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e katërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat tekniketj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT IZBATIMIT TËPUNIMEVE**Afatet e realizimit të punimeve:**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
Nr	Përshkrimi i Punëve	Java 1/Muaji 1	Java 2/Muaji 2	Java 3/Muaji 3	Java 4/Muaji 4	Java 5/Muaji 5
1.						
2.						
3.						
4.						

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojërreshta nëvarësi të zërave të punimeve dhe kollona nëvarësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019-2020-2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 40% e vlerës së fondit limit

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019, 2020 dhe 2021, të certifikuara nga autoritetet përkatëse (Dega e Tatim Taksave) ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1.a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **20%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se sa **80%** e vlerës limit e kontratës që prokurohet

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë profesionale sipas modelit të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të përgjithshme ndërtimi:

Kategoria NP-1 Niveli A “Punime germimi”

Kategoria NP-4 Niveli A “Rruge ,autostrada,mbikalime”

Kategoria NP-7 Niveli A “Ujesjellesa ,gazsjellesa,vajsjellesa,...”

Kategoria NP-11 Niveli A “Ndertime per N/Stacione linja te T/L e te mesem...”

Punime speciale ndertimi:

Kategoria NS-1 Niveli A “Punime per prishjen e ndertimeve”

Kategoria NS-18 Niveli A “Punime topogjeodezike”

2.3.3. Vetdeklarimin nga inxhinierat se atajane te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Për kryerjen e punimeve numri minimal i punonjësve duhet të jetë **10 (dhjetë)**, nga të cilët minimalisht **10 (dhjetë) punonjës duhet të figurojnë në listëpagesat e të paktën 3 muajvetë fundit.**

a) 1 (një) inxhinier ndërtimi - drejtues teknik

Inxhinieri i ndërtimit duhet te jete i pajisur me diplomëtë nivelit të dytënë fushën e inxhinierisë së ndërtimit, të jetë i siguruar me kohë të plotë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, si dhe të ketë kontratën individuale të punës të vlefshme përgjatë periudhës së zhvillimit të punimeve në objekt, të figurojë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë, kontrate pune te vlefshme.

b) 1 (nje) inxhinier ndërtimi

Inxhinieri i ndërtimit duhet te jete i pajisur me minimalisht diplomëbachelor në fushën e inxhinierisë së ndërtimit, të jetë i siguruar me kohë të plotë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, si dhe të ketë kontratën individuale të punës të vlefshme përgjatë periudhës së zhvillimit të punimeve në objekt.

Inxhinieri i ndërtimit duhet të paraqesë një deklaratë ku garanton se nuk do të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë gjithë afatit të zbatimit të kontratës që prokurohet.

- *Në rast se inxhinieri i kërkuar në pikën 2.3.4 germa a, nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe është i disponueshëm në kantier gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, gjë të cilën ai do ta vërtetojë me paraqitjen e deklaratës, atëherë pika 2.3.4 germa b nuk është e detyrueshme të plotësohet.*

c) 1 (nje) inxhinier topograf

Inxhinieri topograf duhet te jete i pajisur me diplomete nivelit te dytesis inxhinier Gjeodet/Inxhinier Topograf/Inxhinier Markshajder/Inxhinier Gjeomatik, te jete i siguruar me kohen te ploten per te paktin 3 (tre) muajt e fundit, si dhe te keten kontraten individuale te punes te vlefshme pergjate periudhes se zhvillimit te punimeve ne objekt.

d) 1 (nje) teknik ndertimi

Tekniku i ndertimit duhet te jete i pajisur me diplomete/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit te mesem profesional / arsimit te larte te akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH", kontrate pune te vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libere pune, dhe te figuroje ne listepagesa te paktin 3 muajt e fundit.

e) 1 (nje) Manovrator

Manovratoret (drejtuesit e makinerive te rندا eksavatorit/ fadromes, makinave ngjesese dhe te asfaltimit) duhet te jene punonjes te specializuar per drejtimin e mjeteve te rندا dhe per keten duhet te paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. (Ne rastin kur punonjesit Manovrator jane te kontraktuar me kontrate pune (respektivisht per mjetet e marra me qera), nuk kerkohet te figurojne ne listepagesat e shoqerise).

f) 2 (dy) shoferë kamioni

Shoferet e kamionit duhet te jene punonjes te specializuar per drejtimin e mjeteve te rندا dhe per keten duhet te paraqesin deshmi nga Drejtoria e Sherbimit te Transportit Rrugor, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente. (Ne rastin kur keto punonjes jane te kontraktuar me kontrate pune (respektivisht per mjetet e marra me qera), nuk kerkohet te figurojne ne listepagesat e shoqerise).

g) 2 (dy) punëtor asfalti

Punetori asfaltit duhet te jete i pajisur me diplomete/kualifikime ekuivalente, nga institucionet e arsimit te mesem profesional / arsimit te larte te akredituara sipas ligjit Nr.15/2017 "Per arsimin dhe formimin profesional ne RSH", kontrate pune te vlefshme, deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, libere pune, dhe te figuroje ne listepagesa te paktin 3 muajt e fundit.

h) 1 (nje) pllakashtrues

i) 1 (nje) hidraulik

j) 1 (nje) elektrikist

k) 2 (dy) punëtorë të thjeshtë (Nuk ka rëndësi klasifikimi profesional)

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojces 8 te DT. Dokumentat e kerkuara me sipër do te paraqiten perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve ankimit, ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

- *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese vertetim te lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shendetsore ne te cilin te jete i percaktuar numri i punonjesve te siguruar per periudhen e mesiperme, shoqeruar me listepagesen perkatese E-Sig, per kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore.*

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----

Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata

Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo sishashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertuesimundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk kapasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
 - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveçkësaj, nuk kapasurkonsultime, komunikime, marrëveshjeapokntrata me ndonjëkonkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimetapodërgesa të veçanta të produkteveaposhërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kurjanëdeklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janëbërë të njohuradhe as nuk do t'ubëhen të njohura me qëllimngaOfertuesikonkurrentëve të tjerë, në çdomënyrëqoftë, para datësdhekohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljesfituesdhelidhjes së kontratës, vetëmnësekërkohe me ligj ose nësedeklarohen në mënyrëspecifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA “Mbi Konfliktin e Interesit”

Deklarata
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:</p> <p>Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.</p> <p>Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil. - Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie. <p>Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).</p> <p>Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.</p>
<p>Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet</p>

nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> • Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi. • Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi. • Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH. <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i></p>

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimittë përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:</p> <p>Unë kam punonjësit e nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.</p>	<p>Punonjës</p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve</p> <p>Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:</p> <p>1. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>2. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>3. _____,me profesion_____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,</p> <p>Makineri e mjete</p> <p>Po [] Jo []</p> <p>Nëse, po, të listohen me të dhënat konkrete</p>

C: DEKLARATË

“Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se,kam në dispozicion dhe/ose do te me vihen

ne dispozicion mjetet, pajisjet teknike dhe asetet e tjera fizike për të realizuar këtë kontratën, si me poshte:

Në pronësi				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
1				

2				
3				
4				
5				

Me qira					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës qerasë(data e fillimit dhe mbarimit)
1					
2					
3					
4					
5					
6					

Kontratë furnizimi				
Materiali/prod ukti për të cilin paraqitet kontrata e furnizimit	Nr. Kont së furnizimit (noterisë)	Afati i kontratës furnizimit (data e fillimit dhe mbarimit)	Të tjera	
1.				
2				
3				
4				

D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se:

Mjetet/pajisjet/makineritë e deklaruara në këtë procedurë prokurimi, pavarësisht formës së disponimit të tyre, do të jene ne dispozicion gjatë zbatimit të kontratës sipas grafikut te punimeve.

Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar:

Z. _____, me profesion _____, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e _____,

etj .,

ideklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
